



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

**AD-GJTHM.nr.1/2023**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICE-Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi**, duke vendosur ne çështjen disiplinore të ngritur ndaj H.A, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Dega në Skenderaj, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala I.B, me adrese te vendbanimit Tuneli i pare Rr.”...”, Mitrovicë pas vlerësimit të ankesës dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit H.A e dt.23.02.2023, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 28.02.2023, merr këtë:

**AKTVENDIM**

**REFUZOHET** e pa bazuar Ankesa disiplinore e dt.13.02.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD-GJTHM.nr.1/2023, e parashtruar nga pala ankuese I.B, kundër Gjyqtarit H.A, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë-Dega në Skenderaj.

**A r s y e t i m i**

Në cilësinë e Nënkyetarit të Gjykatës kam pranuar ankesën e datës 13.02.2023, e parashtruar nga pala I.B, me adrese te vendbanimit Tuneli i pare Rr.”...”, Mitrovicë, në të cilën ankesë ka paraqitur disa ankese ndaj gjyqtarit H.A, gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë Dega në Skenderaj lidhur me lëndën CT.nr.6/22.

Nënkyetari i Gjykatës me shkresën e dt.13.02.2023, i është drejtuar subjektit te hetimit gjyqtarit H.A, duke kërkuar përgjigje me shkrim lidhur me ankesën e palës I.B, e parashtruar ndaj tij.

Gjyqtari i rastit H.A ka dhënë përgjigje-deklarate me dt.23.02.2023, lidhur me ankesën e parashtruar nga I.B, duke i përshkruar të gjitha veprimet e ndërmarra dhe atë: me dt.13.01.2022 trashëgimtari Xh.B përmes përfaqësuesit me autorizim av.M.H ka ushtruar propozim në këtë gjykatë për shqyrtimi të pasurisë trashëgimore respektivisht plotësimin e aktvendimit T.nr.11/2007, pasi më vonë është kuptuar se i ndjeri I.B ka lënë pasuri në emër te tij, e cila figuron në parcelën e evidentuar në certifikatën me nr.15-942-0000415 e dt.03.01.2022 , ku në të njëjtën është ndërtuar një shtëpi. Gjykata pas shqyrtimit të propozimit dhe provave në shkresat e lëndës me dt.02.03.2022 ka mbajtur seancën gjyqësore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimisë të gjetur më vonë, për pronën e paluajtshme me nr.P-71200893-00835-0 ZK Mitrovicë , ku kanë prezentuar përfaqësuesi me autorizim Xh.B av.M.H dhe trashëgimtarët tjerë I.B, S.H, M.K dhe Sh.R. Trashëgimtarët I.B dhe Xh.B kishin deklaruar se e pranojnë pronën që i takon në bazë të ligjit që e ka lënë babai i tyre shprehimisht i kanë përmendura edhe parcelën katastrale, kishin deklaruar se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri tjetër, nuk ka lënë testament gojor e as të shkruar dhe as kontratë për mbajtje të përjetshme dhe kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në ankesën. Trashëgimtarët tjerë S.H, M.K dhe Sh.R kanë pranuar pjesën e pronës , por kanë hequr dorë nga kjo e drejtë në favor të trashëgimlënësve tjerë në pjesë të barabarta. Të gjitha deklaratimet e trashëgimtarëve i ka shënuar në procesverbal, ku ankuese I.B e ka nënshkruar deklaratën pa vërejtje. Lidhur me pretendimet e ankuesit se ne shqyrtim nuk ka marrë pjesë Xh.B është e pabazuar sepse i trashëgimtari Xh. është përfaqësuar nga i autorizuari i tij av.M.H. Sa i përket pretendimit se kjo gjykatë nuk ka qenë kompetente për shqyrtimin e pasurisë së gjetur më vonë, ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse

në rastin konkret është vendosur për pasurin e gjetur më vonë, rrjedhimisht për plotësimin e vendimit të mëparshëm T.nr.11/2007 të dt.22.02.2007 me të cilën është ndarë pasuria e trashëgimtarit I.B dhe trashëgimtarët Xh.B dhe I.B ishin shpallë trashëgimtar nga ½ në tërë pasurin. Pretendim se nuk e ka pranuar aktvendimin CT.nr.6/22 të dt.17.03.2022 , në shkresat e lëndës ekziston fletë kthesa nga e cila konstatohet se aktvendimin e ka pranuar me dt.01.04.2022.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tille është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkrete te Ligjit për Përgjegjësitë disiplinore për Gjyqtare dhe Prokuror nuk mund te kemi një dyshim te qëndrueshëm për veprime te mëtejme, duke marre për baze edhe përgjigjen e marre nga gjyqtar ndaj të cilit është ngritur procedura disiplinore i cili në mënyrë kronologjike ka shpjeguar rastin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore të gjetur më vonë me aktvendimin CT.nr.6/22 të dt.17.03.2022 e që është bërë plotësimi i aktvendimit T.nr.11/2007 i dt.22.07.2007, ku ceket se në procesverbalin e shqyrtimit të trashëgimisë të dt.02.03.2022 gjegjësisht deklaratën trashëguese e ka nënshkruar pa vërejtje paraqitësi i ankesës po ashtu i njëjti me nënshkrimin e tij si në procesverbal është pajtuar që të hjekë dorë nga e drejta e ankesës, ndërsa pretendimin se nuk e ka marrë aktvendimin e Gjykatës në Skenderaj dhe e cila nuk ka qene kompetent të vendos procedurën trashëgimore pasi që sipas fletës posedues palujtshmëria gjendet në fshatin Rahovë Komuna e Mitrovicës, këto pretendime nuk qëndrojnë pasi nga fletë kthesa e kthyer në Gjykatë konstatohet se aktvendimin e gjykatës të dt.17.03.2022 e ka pranuar me dt.01.04.2022 dhe figuron në emër të I.B të cilën fletëkthesë e ka nënshkruar, përputhet me nënshkrimin e deklaratës trashëguese, ndërsa sa i përket kompetencës autoriteti kompetent thekson se gjyqtari në fjalë ashtu edhe siç e ka sqaruar bazën ligjore në Aktvendimin CT.nr.6/2022 të dt.17.03.2022 duke u bazuar në nenin 182 të LPJK-së (Ligji Nr.03/1-007) po ashtu në deklaratën e tij ka theksuar se në rastin konkret është vendosur për pasuri trashëgimore të gjetur më vonë në plotësimin e vendimit të mëparshëm T.nr.11/2007 të dt.22.02.2007 me të cilin vendim është shqyrtuar pasuria e trashëgimtarit J.B. Sa i përket faktik të cilin e ka theksuar paraqitësi i ankesës se nuk ka prezantuar në seancë gjyqësore Xh.B por ka prezantuar përfaqësuesi i tij av.M.H dhe emri i të njëjtit nuk ceket në aktvendim, autoriteti kompetent thekson se në procesverbalin mbi shqyrtimin e trashëgimisë CT.nr.6/2022 të dt.02.03.2022 konstatohet se në seancë prezanton përfaqësuesi av.M.H me autorizim për Xh.B, ndërsa fakti se nuk është cekur emri i përfaqësuesit në Aktvendimin CT.nr.6/2022 të dt.17.03.2023 për autoritetin kompetent nuk paraqet bazë për shkelje disiplinore mirëpo një gabim teknik (lëshim teknik) i cili me kërkesën e palës ka mundur që të përmirësohet.

Nga arsyet e theksuara me lart, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinore te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullore per Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICE**  
**AD-GJTHM.nr.01/2023, dt.28.02.2023**

**Nënkryetar i Gjykatës**  
**Bekim Veliqi**

**Aktvendimi i dërgohet;**

- 1. Këshillit Gjyqësor te Kosovës**
- 2. Parashtruesit të ankesës I.B**
- 3. Gjyqtarit H.A**